



Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen XXXIII-të të mbajtur më 07.07.2015, mori:

## V E N D I M

### I. Nuk akreditohet BPrAL Kolegji “Biznesi” dega në Prizren dhe programet e studimit:

- Menaxhment dhe Ekonomik / BA (180 ECTS);
- Menaxhimi i Emergjencave / BA (180 ECTS);
- Juridik / LLB (240 ECTS).

## A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara me lartë, dhe bazuar në Udhëzimit Administrativ për Akreditim 02/2013, datë 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, dhe fakti që Kolegji “Biznesi” këto programe i zhvillon në njësinë kryesore në Prishtinë dhe degën në Gjakovë me të njëjtin staf akademik, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas afatit të përcaktuar me Ligjin mbi Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, datë 22 korrik 2005.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Biznesi";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë